



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:111720
Datë: 27.01.2025
Numri i dokumentit: 06757672

C.nr.2628/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.H. nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate A.P-D. nga ... kundër të paditurës T.K. Sh.a, me seli në ..., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit juristi N.B, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës, shpërblimit jubilar dhe shtesës prej 0.5% të përvojës së punës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik me datën 22.01.2025, në prani të përfaqësueses së paditësit dhe përfaqësuesit të të paditurës, kurse me datën 27.01.2025, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.H., ashtu që DETYROHET e paditura T.K Sh.a., me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj shumat si në vijim:

- Në emër të shujtave ditore – shpenzimeve të ushqimit, për periudhën 01.06.2019 deri me datë 31.05.2022, për gjithsejtë 745 ditë të punës, t’ia paguajë shumën neto prej 1,933.12 euro, kontribute pensionale në trust nga i punësuarit shumën prej 111.75 Euro, kontribute pensionale në trust nga punëdhënësi shumën prej 111.75 Euro, si dhe tatimin në pagë në ATK shumën prej 190.13 Euro;
- Në emër të shtesës në pagë prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, për periudhën 01.06.2019 deri me datë 31.05.2022, t’ia paguajë shumën prej 1,008.20 Euro, kontribute pensionale në trust nga i punësuarit shumën prej 58.96 Euro, kontribute pensionale në trust nga punëdhënësi shumën prej 58.96 Euro, si dhe tatimin në pagë në ATK shumën prej 112.02 Euro;
- Në emër të një page jubilarë për 10 vite të përvojës, t’ia paguaj shumën prej 604.45 Euro, kontribute pensionale në trust nga i punësuarit shumën prej 34.05 Euro, kontribute pensionale në trust nga punëdhënësi shumën prej 34.05 Euro, si dhe tatimin në pagë në ATK shumën prej 42.50 Euro;

II. DETYROHET e paditura T.K. që paditësit shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë datë 01.06.2022 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën

prej 575.00 euro, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi pranë kësaj gjykate me datën 01.06.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shtesës prej 0.5% mbi përvojën e punës në pagën bazë. Në padi ndër të tjera kanë theksuar se, paditësi është i punësuar tek e paditura nga data 15.01.2020, në vendin e punës Zyrtar i Shitjes në Regjionin e Prishtinës dhe realizon pagë mujore në shumën prej 681.00 Euro bruto. Ka shtuar se në bazë të Marrëveshjes Kolektive të Punës në T. K., të datës 31.05.2019, në bazë të nenit 44 par.4, paditësit i takon shpërblimi i një page mujore për vite jubilarë, në emër të shujtave ditore shumën prej nga 3 euro në ditë duke filluar nga data 01.06.2019 e tutje, si dhe në emër të përvojës së punës shumën prej 0.5% nga data 01.06.2019 e tutje. Edhe në precizimin e kërkesëpadsisë së bërë, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 22.01.2025 dhe fjalës përfundimtare, e autorizuar e paditësit ka mbetur në tërësi pran padisë dhe kërkesës së precizuar, duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022, në emër të shtesës për përvojën e punës 0.5% të pagës bazë t'ia paguaj shumën prej 1,008.20 euro, në emër të shujtave ditore për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022, t'ia paguaj shumën prej 1,933.12 euro, si dhe pagën jubilarë në shumën prej 604.45 euro apo në total shumën prej 3,545.77 euro, po ashtu ka kërkuar pagesën e kontributeve pensionale në vlerë prej 340.97 Euro, si dhe tatimin në pagë në vlerë prej 302.15 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për një përfaqësim në seanca gjyqësore shumën prej nga 135.00 euro apo për tre seanca të mbajtura shumën prej 405.00 Euro, për taksë gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, si dhe për ekspertizë financiare shumën prej 150.00 Euro.

E paditura me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se, pagat jubilarë nuk janë kategori ligjore dhe mbi këtë bazë nuk është as e detyrueshme që të paguhet, sepse të njëjtat janë të kushtëzuara me plotësimin e kushteve të përcaktuara me marrëveshjen mes sindikatës dhe punëdhënësit dhe me performancën pozitive të punëdhënësit, ndërsa në rastin konkret e paditura ka provuar dhe dëshmuar me pasqyra financiare se e paditura që nga vitit 2018 e tutje ka afaruar me humbje milionëshe dhe ka pengesa edhe për pagesën e pagave të rregullta mujore. Ka shtuar se, që nga viti 2005 e deri më tani sistemi i pagave realizohet konform marrëveshjes së vitit 2005, nr. 663/01 e datës 15 shkurt 2005 dhe aneksit të kësaj marrëveshje të vitit 2010 e cila marrëveshje është ende në fuqi nga çka rezulton se kërkesa e paditësve është edhe e pasafatshme dhe e pabazuar. Ka shtuar se në Kontratën Kolektive të Telekomit të Kosovës, të vitit 2019, mundësia e pagesës së beneficioneve të tilla është e lidhur me marrëveshjen PTK-Sindikatë e vitit 2005, që nënkupton se kushti primar është që objektivisht e paditura Telekomit të Kosovës të operojë me me performancë pozitive afariste. Tutje ka theksuar se edhe me rregulloren e punës së T.K, në nenin 38 të kësaj rregulloreje është përcaktuar se T.K do të paguajë shtesën mbi përvojën e punës, si dhe shujtat ditore sipas performancës pozitive financiare të T.K. Ka theksuar se bazuar në ligjin e punës, paditësi padinë e ka ushtruar me datën

24.05.2022, pasi që i ka skaduar afati Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Në seancë të shqyrtimit kryesor dhe fjalës përfundimtare të paraqitur me shkrim ka mbetur në tërësi pran përgjigjës në padi dhe deklarimeve në seancë duke shtuar se iu kanë drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për sqarim dhe interpretim lidhur me kërkesat ligjore rreth validitetit dhe procedurave të regjistrimit të marrëveshjeve kolektive. Nga këto arsye kanë propozuar që me aktvendim të hedhet si e palejueshme dhe e pas afatshme padia e paditësit ose të nxjerr aktgjykim me të cilin e refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe me propozimin e palëve ndërgjyqëse gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 22.01.2025, ka administruar provat si në vijim: Kontrata e punës për kohë të pacaktuar nr.01-5740-379/2015, dt.22.12.2015; vërtetimi nr.05-1471/2022 dt.27.04.2022; vërtetimi nr.05-687/2023 dt. 22.02.2023; marrëveshja në mes të PTK dhe sindikatës dt. 15.02.2005; aneksi i marrëveshjes PTK – Sindikatë e dt.22.03.2010; pasqyrat financiare të TK për periudhën që ka përfunduar me dt.31.12.2019; raporti i auditimit për pasqyrat vjetore të TK për vitin 2020; ekspertiza financiare e dt 02.10.2024 e përpiluar nga eksperti financiar A.A; plotësim ekspertiza e dt.19.11.2024 e përpiluar nga eksperti financiar A.A; lista e pagës për muajin janar dhe shkurt 2005 për B.P; lista e pagës për muajin dhjetor 2004, janar shkurt 2005 për N.G; kërkesa për sqarim dhe interpretim lidhur me kërkesat ligjore rreth validitetit dhe procedurave të regjistrimit të MK e dt. 27.09.2024 e bërë nga e paditura; si dhe raporti vjetor i të paditurës dt.18.03.2024 lidhur me përfomancën e saj.

Nga deklaratimet e palëve në padi, përgjigje në padi dhe seanca gjyqësore, rezulton se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse mbeten faktet nëse për paditësin është krijuar baza ligjore dhe të njëjtit i ka lindur e drejta për realizimin e shpërblimit jubilar, shujtave ditore për ditët e punës dhe kompensimin e shtesës prej 0.5 për përvojën e punës.

Nga vërtetimi nr.05-1471/2022, i datës 27.04.2022, vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 15.01.2010 e vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe realizon të ardhura bruto në shumën prej 681.00 euro.

Në këtë çështje juridike është nxjerr edhe ekspertiza nga lëmia financiare përmes ekspertit financiar A.A. me datën 02.10.2024. Eksperti financiar, duke vepruar sipas aktvendimit të kësaj Gjykate ka bërë kalkulimin e shujtave ditore, shtesave prej 0.5% të përvojës së punës dhe një page jubilarë, në dy periudha të ndryshme kohore dhe atë nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022 dhe nga data 01.06.2019 e deri në datën e përpilimit të ekspertizës. Eksperti financiar, për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022, në mendimin e tij ka konstatuar se shujta ditore për 774 ditë i takon vlera prej 2,322.00 Euro, shtesa për vite të përvojës së punës apo 0.5% në shumën prej 1,008.20 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 58.96 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 58.96 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 112.02 euro, kurse për një pagë jubilarë i takon shuma prej 604.45 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 34.05 euro, kontributi pensional nga

punëdhënësi në shumën prej 34.05 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 42.50 euro. Kurse për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 30.09.2024, shujta ditore në vlerë neto për 1,269 ditë, paditësit i takon shuma prej 3,807.00 euro, shtesa për vite të përvojës së punës apo 0.5% në shumën prej 2,120.59 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 124.011 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 124.011 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 235.62 euro, kurse për një pagë jubilarë i takon shuma prej 604.45 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 34.05 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 34.05 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 42.50 euro.

Në këtë çështje juridike ekspertizën financiare të elaboruar më lartë, eksperti financiar A.A. me datën 19.11.2024 e ka plotësuar sipas aktvendimit të kësaj gjykate të marr në procesverbalin e seancës së datës 13.11.2024. Eksperti financiar, edhe njëherë ka bërë kalkulimin e gjitha formave të kompensimit që i kërkon paditësi përmes padisë që i referohen shujtave ditore, shtesave prej 0.5% të përvojës së punës dhe një page jubilarë, në dy periudha të ndryshme kohore dhe atë nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022 dhe nga data 01.06.2019 e deri në datën e përpilimit të ekspertizës. Eksperti financiar, për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022, në mendimin e tij ka konstatuar se shujta ditore për 745 ditë i takon vlera prej 1,933.12 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 111.75 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 111.75 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 190.13 euro, shtesa për vite të përvojës së punës apo 0.5% në shumën prej 1,008.20 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 58.96 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 58.96 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 112.02 euro, kurse për një pagë jubilarë i takon shuma prej 604.45 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 34.05 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 34.05 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 42.50 euro. Kurse për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 30.09.2024, shujta ditore në vlerë neto për 1,217 ditë, paditësit i takon shuma prej 3,143.80 euro, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 182.55 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 182.55 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 324.65 euro, shtesa për vite të përvojës së punës apo 0.5% në shumën prej 2,120.59 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 124.01 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 124.01 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 235.62 euro, kurse për një pagë jubilarë i takon shuma prej 604.45 Euro neto, kontributi pensional nga punëtori në shumën prej 34.05 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi në shumën prej 34.05 euro, kurse tatimi në pagë në shumën prej 42.50 euro.

Eksperti në fjalë ekspertizën e tij e ka mbrojtur edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 13.11.2024 dhe 22.01.2025, ku ndër të tjera ka theksuar se mbetet pran konstatimeve të dhëna në to, kurse në raport me plotësimin e ekspertizës të bërë me datën 19.11.2024, ka theksuar se në bazë të vendimit të kësaj Gjykate me të cilin është caktuar eksepert obligim ka qenë që të bëhet përlllogaritja e ditëve të pushimit mjekësor, ku pas pranimin të informatave nga e paditura për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022, janë zbritur 13 ditë të pushimit mjekësor për këtë periudhë, gjithmonë sipas informatave të pranuar nga e paditura. Ndërsa për periudhën 01.06.2019 -14.10.2024 janë zbritur 52 ditë të pushimit mjekësor dhe i është bërë kalkulimi në vlerën prej 3 euro për të dy periudhat dhe kalkulimet janë të sakta dhe janë të

paraqitura në tabelën në fq.6 dhe 7 të ekspertizës. Sa i përket pagës jubilarë, e paditura ka lëshuar vërtetim për të punësuarin nr.05-1471/22, dt.27.04.2022 ku paga e paditësit është 681.00 euro bruto. Kalkulimi lidhur me pagën jubilarë është bërë në atë mënyrë që është zbritur kontributi pensional i punëtorit dhe punëdhënësit si dhe tatimi në pagë. Sa i përket 0.5% në fq. nr.4 të ekspertizës në tabelën nr.1, sa i përket kompensimit të shtesave për përvojën e punës në lartësi prej 0.5% në muajin shtator 2024 dhe tetor 2024 janë kalkuluar në bazë të hyrjes në fuqi të ligjit nr.08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficioneve për pagën minimale. Pra si përfundim për periudhën 01.06.2019-31.05.2022 sikur padia e paditësit të ishte e bazuar totali i përgjithshëm i obligimit nga e paditura ndaj paditësit duke përfshirë kompensimin e shtesave 0.5%, pagën jubilarë për 10 vite përvojë pune dhe shujta ditore është paga neto apo 0.5% në shumën prej 1008.20 euro, paga neto për 10 vite të përvojës së punës apo paga jubilarë 604.45 euro, ndërsa paga neto për shujta ditore 1933.12 euro, kontribut pensional që duhet paguar në trustin pensional është 340.97 euro, tatim në pagë që duhet paguar në dobi të buxhetit të ATK-së është 302.15 euro. Ndërsa për periudhën 01.06.2019 – 14.10.2024 sikur padia e paditësit të ishte e bazuar totali i përgjithshëm i obligimit nga e paditura ndaj paditësit duke përfshirë kompensimin e shtesave 0.5%, pagën jubilarë për 10 vite përvojë pune dhe shujta ditore është paga neto apo 0.5% në shumën prej 2120.59 euro, paga neto për 10 vite të përvojës së punës apo paga jubilarë në shumën prej 604.45 euro, ndërsa paga neto për shujta ditore 3,143.80 euro, totali i përgjithshëm i këtyre shumave është 5,868.84 euro, kontribut pensional që duhet paguar në trustin pensional është 613.12 euro, tatim në pagë që duhet paguar në dobi të buxhetit të ATK është 560.27 euro.

-Kompensimi lidhur me shpenzimet e ushqimit për ditët e punës.

Lidhur me pretendimet e paditësit sa i përket kësaj çështje kontestimore, Gjykata fillimisht thekson se faktin se këtu e paditura me datë 31.05.2019 ka nënshkruar Marrëveshjen Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës, marrëveshja me numër 01-3207/19, marrëveshje kjo e nënshkruar nga e paditura me federatën sindikale të punëtorëve në Telekomin e Kosovës.

Sa i përket kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, Gjykata sjell në vëmendje dispozitën e nenit 44 paragraf 3 të marrëveshjes kolektive të punës në Telekomin e Kosovës e cila përcakton se: punonjësve iu njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për një ditë pune prej 3 euro. Po ashtu me nenin 38, paragrafi 7 të Rregullores së Punës në T.K, e datës 29.11.2019, është përcaktuar se të punësuarve ju njihet e drejta e shtesës për përvojë të punës prej 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës në punë si dhe shujta ditore e përcaktuar me kontratën kolektive.

Nga dispozitat në fjalë po ashtu derivon obligimi i të paditurës që punëtorëve të saj tua paguaj shpenzimet e ushqimit, ndërsa fakti se paditësit nuk i janë paguar shpenzimet e ushqimit është vërtetuar nga ekspertiza financiare, e po ashtu fakti i tillë është pohuar po ashtu nga e paditura në përgjigje në padi dhe seanca gjyqësore ngase të njëjtit e kanë kontestuar kërkesën e paditësit se të njëjtit i takojnë shpenzimet e ushqimit. Marrë parasysh faktin se nga dispozita e lartëcituar derivon obligimi i të paditurës për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, Gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurën për pagesën e shpenzimeve të

ushqimit për paditësin.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë lidhur me këtë bazë, Gjykata me propozimin e përfaqësuesit të paditësit ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, e cila u elaborua më lartë në këtë arsyetim, ku eksperti financiar ka konstatuar se për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022, në mendimin e tij ka konstatuar se shujta ditore në vlerë neto paditësit, për gjithsejtë 745 ditë të punës, i takon shuma prej 1,933.12 euro, kontribute pensionale në trust nga i punësuarit shumën prej 111.75 Euro, kontribute pensionale në trust nga punëdhënësi shumën prej 111.75 Euro, si dhe tatimin në pagë në ATK shumën prej 190.13 Euro. Lidhur me këtë pjesë të llogaritjes, Gjykata plotësimin e ekspertizës të datës 19.11.2024, e gjeti si të besueshme e profesionale, andaj, të njëjtës ia fali besimin.

-Kompensimi lidhur me shtesën prej 0.5% mbi pagën bazë

Sa i përket shtesës mbi pagën bazë në vlerë prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, gjykata iu referua bazës ligjore përkatëse, gjegjësisht nenit 44 paragrafi 2 të marrëveshjes kolektive të punës në T.K., në të cilën dispozitë është përcaktuar se: punonjësve u takon kompensimi i shtesave për përvojë pune, 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Po ashtu me dispozitën e nenit 38, paragrafi 7 Rregullores së punës në Telekomin e Kosovës e datës 29.11.2019, e cila ka përcaktuar se: të punësuarve ju njihet e drejta e shtesës për përvojë të punës prej 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës në punë si dhe shujta ditore e përcaktuar me kontratën kolektive.

Nga dispozitat e lartë cituara vihet në interpretimin se edhe marrëveshja kolektive e të paditurës dhe rregullorja e punës e të paditurës kanë përcaktuar të drejtën e të punësuarve – këtu paditësit – që të iu paguhet shtesa prej 0.5 % për çdo vit të përvojës së punës dhe e paditura nuk ka ofruar prova që shtesa e tillë iu është paguar të njëjtë.

Mbi këtë bazë, gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, ku nga eksperti në bazë të vërtetimeve mbi përvojën e punës të bashkëngjitur nga paditësi është llogaritur se: për periudhën kohore nga data 01.06.2019 e deri me datën 31.05.2022, shtesa prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, paditësit i takon në shumën prej 1,008.20 Euro, kontribute pensionale në trust nga i punësuarit shumën prej 58.96 Euro, kontribute pensionale në trust nga punëdhënësi shumën prej 58.96 Euro, si dhe tatimin në pagë në ATK shumën prej 112.02 Euro.

- Kompensimi lidhur me pagën jubilarë

Sa i përket kërkesës për shpërblimin e pagës jubilarë, Gjykata i referohet nenit 44 par. 4 Marrëveshjes Kolektive të Punës në T.K. me Nr. 01-3207/19, të datës 31.05.2019, ku ishte paraparë që: “Punonjësve u takon shpërblimi jubilar për 10 vite përvojë pune pandërprerë të punëdhënësi i fundit 1 pagë mujore të tij, 20 vite të përvojës pandërprerë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 2 paga mujore të tij dhe për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 3 paga mujore të tij”. Po ashtu me nenin 38 par. 8 të Rregullores së Punës në Telekomin e Kosovës, të datës 29.11.2019 përcaktohet se: “për çdo dhjetë (10) vite të punës së

pandërprerë në TK të punësuarit i jepet pagesë jubilarë në lartësi të një page të fundit të punëtorit”.

Nga dispozitat e lartë cituara të Marrëveshjes Kolektive dhe Rregullores së lartcekur të miratuara nga e paditura, rezulton se në mënyrë kategorike është përcaktuar detyrimi që e paditura, punëmarrësve të saj të iu paguajë pagën jubilarë varësisht nga vitet e përvojës së punës, ndërsa fakti që paditësit nuk i janë paguar pagat jubilarë përkundër arritjes së vitit jubilar, është pohuar edhe nga e paditura përmes përgjigjes në padi dhe përgjatë seancave gjyqësore, sepse e paditura e ka kontestuar detyrimin e saj për pagesën e pagave jubilarë.

Bazuar në karakterin detyrues të dispozitave të lartë cituara të marrëveshjes kolektive të punës në Telekomin e Kosovës, Gjykata vlerëson se për paditësin është krijuar e drejta për të kërkuar realizimin e shpërblimit jubilar.

Sa i përket kushtit për realizimin e shpërblimit jubilar, Gjykata gjen se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me datë 15.01.2010 vazhdon me kontratë për kohë të pacaktuar sipas vërtetimit me Nr. 05-1471/22 të datës 27.04.2022. Po ashtu nga vërtetimi në fjalë rezulton se paditësi vitin e dhjetë jubilar e ka arritur në vitin 2020, pra gjatë kohës sa ka e vlefshme Marrëveshja Kolektive e punës në Telekomin e Kosovës.

Lartësinë e pagës bazë për paditësit Gjykata e vërtetoi bazuar në vërtetimet e administruara si prova në procedurë gjyqësore, ku nga vërtetimi me numër Nr. 05-1471/22 të datës 27.04.2022, vërtetohet fakti se paditësi realizon pagë bazë tek e paditura 681.00 Euro burto, ku pas kalkulimit nga eksperti financiar, rezulton se të njëjtit nga kjo pagë, neto i takon shuma prej 604.45 Euro, kontribute pensionale në trust nga i punësuarit shumën prej 34.05 Euro, kontribute pensionale në trust nga punëdhënësi shumën prej 34.05 Euro, si dhe tatimin në pagë në ATK shumën prej 42.50 Euro.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj së bashku me kamatën ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht datë 01.06.2022, e deri në pagesën definitive.

Me rastin e vendosjes gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të të paditurës por që të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendosje ndryshe. E paditura ka pretenduar se padia e paditësit është e pas afatshme, por që sipas vlerësimit të kësaj gjykate një pretendim i tillë është i pabazuar, kjo për faktin se kërkesa e paditësit ka të bëjë me kërkesa monetare, detyrime këto për të cilat nuk aplikohen dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës dhe një kërkesë e tillë nuk është e lidhur me afat për paraqitjen e padisë.

E paditura po ashtu ka pretenduar se përmbushja e detyrimeve të tilla është e kushtëzuar me performancën pozitive financiare të të paditurës, megjithatë gjykata gjen se kërkesa e paditësit gjen mbështetje në dispozitat e Marrëveshjen Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës dhe të rregullores së punës, ashtu që në Marrëveshjen Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës gjegjësisht nenit 44 të të njëjtës marrëveshje obligimi i përmbushjes së këtyre detyrimeve nga e

paditura nuk është kushtëzuar me performancën pozitive financiare, por që e paditura me nënshkrimin e marrëveshjes kolektive ka marrë obligimin që krahas pagës bazë tua paguajë punëtorëve edhe shtesat, përfshirë shpenzimet e ushqimit, shtesën prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, si dhe pagën jubilarë për çdo 10 vite të përvojës së punës.

Tutje, e paditura ka pretenduar se mundësia e pagesës së beneficioneve të tilla është e lidhur me marrëveshjen PTK-Sindikatë e vitit 2005 dhe aneksin e saj të vitit 2010, megjithatë sa i përket këtij pretendimi Gjykata, i referohet nenit 54 paragrafi 2 të Marrëveshjes Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës e cila përcakton se: Zbatimi i marrëveshjes TK- Sindikatë për pagat dhe ndarjet e bonusit Nr. 663/01 e datës 15.02.2005 dhe aneksi i kësaj marrëveshje të vitit 2010 si dhe sigurimi shëndetësor i punëtorëve, garantohen nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje për periudhën e vlefshmërisë në fjalë. Nga dispozita e tillë e marrëveshjes kolektive në Telekomin e Kosovës shihet se pagesa e shujtave, pagave jubilarë dhe shtesës për përvojën e punës nuk është e kushtëzuar domosdoshmërisht me marrëveshjen TK-Sindikatë të vitit 2005 dhe as me aneksin e saj të vitit 2010, por që palët janë dakorduar që të garantohet edhe zbatimi marrëveshjes së vitit 2005 dhe aneksit të saj të vitit 2010.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të të paditurës, megjithatë të njëjtat i gjeti pa ndikim në një vendosje ndryshe.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, gjykata detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, kjo duke u bazuar në nenin 450 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke përfshirë shpenzimet e domosdoshme të krijuara gjatë procedurës gjyqësore, dhe atë: për përfaqësim në tre seanca gjyqësore në shumën prej 405.00 euro (135.00 euro për secilën seancë), për ekspertizë financiare shumën prej 150.00 euro dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, e në total vlera e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 575.00 euro.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
C.nr.2628/22, datë 27.01.2025

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.